



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:278455

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05874357

KPPP.nr.2140/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Artmotion SH.P.K., me NUI: 810200866, me seli në Prishtinë, rruga nr. "Lidhja e Pejës", Zona Industriale, kundër debitorit Selmans Network SH.P.K., me seli në Prishtinë, rruga nr. "Jakov Xoxa", Kompleksi Blini, me NUI: 810815061, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.793/23 të datës 24.11.2023 të Përmbartuesit Privat Gjokë Radi me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Selmans Network SH.P.K., ANULOHET urdhri përmbartimor P.nr.793/23 i datës 24.11.2023, i Përmbartuesit Privat Gjokë Radi dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Artmotion SH.P.K., ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.793/23 të datës 24.11.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht Faturës Nr. F22-10-0000138 të datës 01.10.2022; Faturës Nr. F23-10-0000015 të datës 01.10.2023; Faturës Nr. F23-09-0000152 të datës 01.09.2023; Faturës Nr. F23-09-0000431 të datës 01.09.2023; Faturës Nr. F23-09-0001308 të datës 01.09.2023; Faturës Nr. F23-10-0000017 të datës 01.10.2023; Faturës Nr. F23-08-0001193 të datës 01.08.2023; Faturës Nr. F23-08-0001192 të datës 01.08.2023; Faturës Nr. F23-07-0000415 të datës 01.07.2023; Faturës Nr. F23-07-0000178 të datës 01.07.2023; Faturës Nr. F23-06-0001309 të datës 01.06.2023; Faturës Nr. F23-01-0000118 të datës 01.01.2023; Faturës Nr. F23-01-0000518 të datës 01.01.2023; Faturës Nr. F23-12-0000210 të datës 01.12.2023;

Faturës Nr. F23-12- 0000211 të datës 01.12.2023; Faturës Nr. F22-11-0001336 të datës 01.11.2022; Faturës Nr. F23-03-0000300 të datës 01.03.2023; Faturës Nr. F22-11-0001335 të datës 01.11.2022; Faturës Nr. F23-02-0000260 të datës 01.02.2023; Faturës Nr. F23-02-0000259 të datës 01.02.2023; Faturës Nr. F23-06-0001306 të datës 01.06.2023; Faturës Nr. F23-05-0000422 të datës 01.05.2023; Faturës Nr. F23-03-0000298 të datës 01.03.2023; Faturës Nr. F23-05-0000183 të datës 01.05.2023; Faturës Nr. F23-04-0000051 të datës 01.04.2023 dhe Faturës Nr. F23-04-0000474 të datës 01.04.2023; me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit për përmbnim të bëjë pagesën sipas faturave të prezantuara në shumën prej 5,190.00 €, si dhe shpenzimet përmbnimore, në të kundër përmbnimit ndaj debitorit të zbatohet me bllokimin e llogarive bankare dhe bartjen e mjeteve monetare në llogarinë e kreditorit, ndërsa nëse përmbnimit në llogaritë bankare të debitorit është i pasuksesshëm, përmbnimit të zbatohet me regjistrimin, vlerësimin dhe shitjen e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme që gjenden në posedim dhe pronësi të debitorit, deri në pagesën e plotë të borxhit, kamatës dhe shpenzimeve të përmbnimit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar urdhrin përmbnimit, ku ndër të tjerash ka deklaruar se urdhri për përmbnimit nuk i plotëson kriteret e përcaktuara ligjore, për faktin se faturat nuk përmbajnë nënshkrimin e personit të autorizuar nga ana e debitorit, si dhe vulën e tij, ashtu që me asnjë prove nuk është dëshmuar se të njëjtat janë dorëzuar tek debitori. I ka propozuar gjykatës që të pranohet si i bazuar në tërësi prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri për lejimin e përmbnimit dhe procedura përmbnimore të përfundohet.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se me debitorin kanë qenë në marrëdhënie kontraktuese, sipas së cilës faturat burojnë nga kjo kontratë dhe se debitori ka pranuar shërbimin nga pala kreditore, gjë e cila vërtetohet nga kartela e debitorit përmes kryerjes së pagesave dhe nga konfirmimi përmes “Marrëveshjes për pagesë të borxhit” të datës 01.09.2023, ku është specifikuar borxhi total në shumën prej 5,190.00 €. Më tutje ka theksuar se dërgimi i faturave është bërë në baza mujore dhe se në bazë të nenit 40 par. 2 të Ligjit Nr. 04/L-094 për Shërbimet e Shoqërisë Informatike është përcaktuar se nuk kërkohet që fatura të nënshkruhet. Në fund ka shtuar faturat e lartcekura kanë datën dhe afatin e pagesës dhe të gjitha këto janë dokumente të besueshme dhe kanë në përmbajtjen e saj elementet kryesore ligjore që përbëjnë titull ekzekutiv. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbnimit.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Faturën Nr. F22-10-0000138 të datës 01.10.2022; Faturën Nr. F23-10-0000015 të datës 01.10.2023; Faturën Nr. F23-09-0000152 të datës 01.09.2023; Faturën Nr. F23-09-0000431 të datës 01.09.2023; Faturën Nr. F23-09-0001308 të datës 01.09.2023; Faturën Nr. F23-10-0000017 të datës 01.10.2023; Faturën Nr. F23-08-0001193 të datës 01.08.2023; Faturën Nr. F23-08-0001192 të datës 01.08.2023; Faturën Nr. F23-07-0000415 të datës 01.07.2023; Faturën Nr. F23-07-0000178 të datës 01.07.2023; Faturën Nr. F23-06-0001309 të datës 01.06.2023; Faturën Nr. F23-01-0000118 të datës 01.01.2023; Faturën Nr. F23-01-0000518 të datës 01.01.2023; Faturën Nr. F23-12-0000210 të datës 01.12.2023; Faturën Nr. F23-12-0000211 të datës 01.12.2023; Faturën Nr. F22-11-0001336 të datës 01.11.2022; Faturën Nr. F23-03-0000300 të datës 01.03.2023; Faturën Nr. F22-11-0001335 të datës 01.11.2022; Faturën Nr. F23-02-0000260 të datës 01.02.2023; Faturën Nr. F23-02-0000259 të datës 01.02.2023; Faturën Nr. F23-06-0001306 të datës 01.06.2023; Faturën Nr. F23-05-0000422 të datës 01.05.2023; Faturën Nr. F23-03-0000298 të datës 01.03.2023; Faturën Nr. F23-05-0000183 të datës 01.05.2023; Faturën Nr. F23-04-0000051 të datës 01.04.2023 dhe Faturën Nr. F23-04-0000474 të datës 01.04.2023; në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit

1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se faturat në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përbarim nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme, për faktin se këto fatura në rastin konkret janë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk janë pranuar nga debitori, përkatësisht të njëjtat nuk përmbajnë as nënshkrimin e pranuesit – debitorit dhe nuk ka dëshmi se të njëjtat janë pranuar nga debitori. Andaj, duke qenë së debitori nuk i ka pranuar në mënyrë të rregullt, si të tilla të njëjtat nuk mund të shërbejnë si dokumente të besueshme dhe nuk kanë tipare të përbarueshmërisë.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të kreditorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përbarimi.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përbarim, e mbi bazën e të cilit Përbaruesi privat ka lejuar përbarimin, nuk ka tipare të përbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përbaruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundojë në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 2140/23, datë 28.06.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.